



Republika e Kosovës


Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS
Presednik Opštine – Municipal Mayor



**LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,
Z. SMAJL LATIFI**

NGA DATA 11.11.2024 DERI MË 15.11.2024

NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-02-4969-2024
2.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-4971-2024
3.	Vendim për caktimin e këshillit organizues për nder të 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit Kombëtar	NRP-02-4996-2024
4.	Vendim për punë shtesë dhe për punët e paparapara të menaxherit të projektit	NRP-02-4997-2024
5.	Vendim për mbështetje financiare	NRP-02-4999-2024
6.	Vendim për caktimin e komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave	NRP-02-5000-2024
7.	Vendim për caktimin e komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave	NRP-02-5001-2024
8.	Vendim për punë shtesë dhe për punët e paparapara të menaxherit të projektit	NRP-02-5005-2024
9.	Vendim për caktimin e Grupit punues për hartimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komunën e Rahovecit	NRP-02-5009-2024
10.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-5011-2024
11.	Vendim për ndalimin e doracakëve për mësimdhënës	NRP-02-5013-2024



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES/KABINET PREDSEDNIKA OPSTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4969 Nr. i faq/Br.str/No.pg 200
Data/Datum/Date 12 / 11 / 2024
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

- Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Furnizim me pajisje të teknologjisë informative”, me Nr. prokurimi: 623-24-11036-5-5-8 dhe Nr. të brendshëm: 623-24-061-1-2-1, të datës 29.10.2024, në këtë përbërje:
 - 1.1. Bekim Krasniqi, kryesues;
 - 1.2. Enise Dina, anëtare;
 - 1.3. Veton Kabashi, anëtar.
- Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Furnizim me pajisje të teknologjisë informative”, me Nr. prokurimi: 623-24-11036-5-5-8 dhe Nr. të brendshëm: 623-24-061-1-2-1, të datës 29.10.2024.
- Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/4902, i datës 30.10.2024.
- Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality of Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4971 Nr. i faq./Br.str./No.pg 201
Data/Datum/Date 12/11/24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Ndërtimi i rrugës Sapniq - Nashpall", me numër të kontratës: 623-24-7151-5-1-1/C631, si në vijim:
 - 1.1. "P.M.N." Sh.p.k., me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Zenun Tolaj, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Përparim Krasniqi, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modulit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës

brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
- 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërbljerjen;
- 4.4. Pas pranimit të urdhërbljerjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërbljerjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
- 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
- 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
- 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.12. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
- 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
- 4.14. T'i japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
- 4.15. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.

5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:

- 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës; dhe
- 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Menaxheri i kontratës,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,*
- *Spektori i Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*


Smajl Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e këshillit organizues për nder të 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit Kombëtar

- Caktohet** këshilli organizues për nder të 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit Kombëtar, në këtë përbërje:
 - 1.1. Fatmir Iska, kryesues;
 - 1.2. Afrim Dina, anëtar;
 - 1.3. Avni Morina, anëtar;
 - 1.4. Nora Boshnjaku, anëtare;
 - 1.5. Naser Dula, anëtar;
 - 1.6. Muharem Morina, anëtar;
 - 1.7. Qemajl Krasniqi, anëtar;
 - 1.8. Saranda Sallteku, anëtare;
 - 1.9. Dervish Çadraku, anëtar;
 - 1.10. Blerta Gashi, anëtare;
 - 1.11. Feriz Thaqi – OVL e UÇK-së, anëtar.
- Këshilli organizues ka për detyrë që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet organizative për shënimin e 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit Kombëtar.
- Obligohet këshilli që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
- Këshilli organizues është i obliguar që t'i raportojë kryetarit të Komunës mbi ecurinë, mbarëvajtjen dhe shpenzimet e organizimit.
- Këshilli do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat të arsyeshëm.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e këshillit organizues dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
- Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e këshillit organizues,
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për punët shtesë dhe për punët e paparapara e menaxherit të projektit dhe e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë me Nr. Prot. 1503, të datës 29.4.2024, në projektin **"Rregullimi i kanaleve të kullimit të tokave bujqësore – Lot 3 – Vazhdimi i ndërtimit të kanalit të kullimit të tokave bujqësore në Ratkoc"** me Nr. të Prokurimit: 623-21-2485-5-1-1/C300, në shumën prej 55,289.95€ (pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë euro e nëntëdhjetë e pesë cent).
2. Ky vendim merret pasi është konstatuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe menaxheri i kontratës së projektit dhe verifikimit të gjendjes në terren, që projekti është në fazën përfundimtare dhe për t'u funksionalizuar është e nevojshme që të kryhen punë shtesë.
3. Obligohet Sektori i Prokurimit që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zhvillimin e procedurave sipas ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Menaxheri i Projektit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Zyrës së Prokurimit,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Menaxherit të Projektit,
- Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – President of Municipality – Municipal Mayor

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 4999 Nr. i faq./Br.str./No.pg 2

Data/Datum/Date 13/11/24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 21, paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2, të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, me Nr.1427, të datës 28.4.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e z. Xhevat Krasniqi nga Pastaselë, me Nr. Prot. 3491, të datës 13.11.2024, për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro), për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe për blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Z. Xhevat Krasniqi vuan nga sëmundja e rëndë, i cili ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e tij. Shërimi i sëmundjes për të lartpërmendurin ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të. Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave kanë kosto të lartë financiare, e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes së tij, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje. Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- Z. Xhevat Krasniqi nga Pastaselë,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 5000 Nr. i faq/Br.sht/No.pg 2

Data/Datum/Date 13 / 11 / 24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 22 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 27 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave

- Caktohet** komisioni për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas planit dinamik realizues në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në këtë përbërje:
 - 1.1. Kosovare Gashi, kryesues;
 - 1.2. Artan Asllani, anëtar;
 - 1.3. Jetmir Ukaj, anëtar.
- Komisioni ka për detyrë që të bëjë mbikëqyrjen dhe monitorimin e realizimit të kontratave dhe të përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, respektivisht ecurinë e zbatimit të ofertës së prezantuar, ecurinë e zbatimit të planit dinamik, realizimin e kontratës dhe implementimin dhe arritjen e qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme.
- Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.
- Komisioni do të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në baza periodike çdo 6 (gjashtë) muaj, dhe atë më së largu më datë 15 maj dhe më datë 15 nëntor të çdo viti.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë dhe ka mandat deri më datë 31.12 2025.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, dhe
- Arkivit.

Smajl Laçi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presidentin Opštine – Municipal Mayor

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESDENIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 5001 Nr. i faq./Br.str./No.pg 3

Data/Datum/Date 13/11/24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 22 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 27 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave

- Caktohet** komisioni për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas planit dinamik realizues në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, në këtë përbërje:
 - 1.1. Fidan Hoti, kryesues;
 - 1.2. Artan Asllani, anëtar;
 - 1.3. Jetmir Ukaj, anëtar;
- Komisioni ka për detyrë që të bëjë mbikëqyrjen dhe monitorimin e realizimit të kontratave dhe të përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, respektivisht ecurinë e zbatimit të ofertës së prezantuar, ecurinë e zbatimit të planit dinamik, realizimin e kontratës, implementimin dhe arritjen e qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme.
- Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.
- Komisioni do të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në baza periodike, respektivisht çdo 6 (gjashtë) muaj.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë dhe ka mandat deri më datë 31.12.2025.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECI / OPŠTINA ORAHOVAC
KRYETARI I KOMUNËS / PRESDENIK OPŠTINE
II
RAHOVEC
ORAHOVAC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 5005 Nr. i faq/Br.str/No.pg 3
Data/Datum/Date 14 / 11 / 24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për punët shtesë dhe punët e paparapara e menaxherit të projektit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë me Nr. Prot. 3498, të datës 13.11.2024, në projektin **"Fushat sportive dhe parqet Nagac, Rahovec, Xërxë, Pataqan i Epërm, Hoçë e Vogël dhe Zatriq"** me Nr. të Prokurimit 623-24-3759-5-2-1 dhe Nr. të Brendshëm: 623-24-035-5-2-1 në shumën prej 17,995.00€ (shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë euro).
2. Ky vendim merret pasi është konstatuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe menaxheri i kontratës së projektit dhe verifikimit të gjendjes në terren, që projekti është në fazën përfundimtare dhe për t'u funksionalizuar është e nevojshme që të kryhen punë shtesë.
3. Obligohet Sektori i Prokurimit që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zhvillimin e procedurave sipas ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe menaxheri i projektit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Zyrës së Prokurimit,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Menaxherit të projektit,
- Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine / Municipal Mayor



Nr./Br./No. 5009 Nr. i faq./Br.str./No.pg. 3
Data/Datum/Date 14/11/24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 16 paragrafi 2 pika 2.3 dhe nenit 38 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023"), nenit 26, nenit 27 dhe nenit 34 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, pikës 2 dhe 5 të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr. 08/226 i datës 23.10.2024 për miratimin e Katalogut të Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Rregullores për Oranizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komunën e Rahovecit

- Caktohet** Grupit Punues për hartimin e Rregullores për Oranizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1 Agron Thaqi – Zyra e Burimeve Njerëzore, kryesues
 - 1.2 Isak Hoti – Udhëheqës i Zyrës Ligjore, anëtar
 - 1.3 Lendrit Qeli – Udhëheqës i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtar
 - 1.4 Blerta Gashi – Zyrtare për Informim, anëtare
 - 1.5 Mirsad Shala – Zyrtar Ligjor, anëtar
 - 1.6 Jeton Krasniqi – Drejtorja për Arsim, anëtar
 - 1.7 Mevlyde Kafexhiu – Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtare
- Grupi Punues ka për detyrë hartimin e Rregullores për Oranizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komunën e Rahovecit, të cilën do t'ia paraqes për pëlqim dhe veprime të mëtutjeshme Kryetarit të Komunës.
- Obligohet Grupi Punues që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.
- Grupi Punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/3026 i datës 13.09.2024.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues,
- Nësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore,
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
~~Komuna e Rahovecit~~
~~Opština Orahovac / Municipality Rahovec~~
Kryetari i Komunës – Presidenti Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 5011 Nr. i faq./Br.str./No.pg 4
Data/Datum/Date 15 / 11 / 24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Shërbimet e energjisë (ESCO) për Komunën e Rahovecit", me numër të kontratës: 623-22-11049-2-1-1/C443, si në vijim:
 - 1.1. "P.M.N." Sh.p.k me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Zenun Tolaj, **CAKTOHET** menaxhere e Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Përparim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës

brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblertjen;
 - 4.4. Pas pranimit të urdhërblertjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblertjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
 - 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
 6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/3135 i datës 12.12.2022.
 7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Menaxheri i kontratës,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,*
- *Spektori i Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*

Smajl Lafi
Kryetar i Komunes
Zyrtar Kryesor Administrativ





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsim në Komunitet të Republikës së Kosovës, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, , nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për ndalimin e doracakëve për mësimdhënës

1. **NDALOHET** në të gjitha shkollat e komunës së Rahovecit, përdorimi i doracakut për mësimdhënës “Edukimi Seksual dhe Shëndeti Riprodhues i Shëndoshë dhe i Sigurt”, i miratuar nga MASHTI.
2. Obligohet Drejtoria për Arsim dhe të gjitha shkollat në territorin e komunës së Rahovecit, të mos e përdorin doracakun e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, gjatë zhvillimit të procesit mësimor.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Pas koordinimit me Drejtorinë për Arsim në Komunën e Rahovecit dhe analizimit të detajuar të doracakut “Edukimi Seksual dhe Shëndeti Riprodhues i Shëndoshë dhe i Sigurt”, i miratuar nga MASHTI, është vërtetuar se i njëjti ka përmbajtje të dëmshme dhe abuzuese për fëmijët në shkolla.

Ky vendim merret me qëllim të parandalimit të efekteve negative dhe dëmeve që mund t’u shkaktojë fëmijëve dhe nxënësve përfshirja në përdorim i doracakëve të edukimit seksual dhe shëndetit riprodhues.

Përdorimi eventual i këtyre doracakëve është i rrezikshëm për mirëqenie, shëndetin dhe edukatën e fëmijëve, e në veçanti për ata që i takojnë moshës së mitur.

Për më tepër, përdorimi i këtyre doracakëve është në kundërshtim me normat morale të shoqërisë sonë.

Vendimi u dërgohet:

- Drejtorisë për Arsim,
- Drejtorëve të ShFMU, ShML dhe IAAP,
- Zyrës për Informim.

